



DREJTORIA E ARSIMIT NË KLINË

04 Nr. 111-312 / 2018

Klinë, më 17.01.2018

Drejtori i DKA-së: Arben Limanaj



Mbështetur në nenin 8, pika 1, dhe nenin 7 pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë shpall :

K O N K U R S

POZITA TË LIRA				
Nr.	Pozita	Shkolla	Orë pune	Fillon punën
1.	2 punëtorë ndihmës	SHFMU "Motrat Qiriazhi" njëri në Zajm	40	Pas konkursit

KUSHTET:

- Për këto vende të punës kërkohet të jetë banor i përhershëm i Komunës së Klinës.

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi

Punëtori ndihmës kujdeset për mirëmbajtjen, pastërtinë dhe rregullimin e të gjitha hapësirave shkollore të përcaktuara nga drejtori, brenda orarit të punës;

Të tregojë respekt, sjellje kolegjiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;

I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Aplikacioni merret në DKA, duke ia bashkëngjitur dokumentet tjera si më poshtë:

- Diploma (certifikata) shkollore e fotokopjuar dhe e vertetuar nga organi përkatës juridik – noteri.
- Certifikata e lindjes.
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Dokumenti i përvojës së punës (nëse ka).
- Vërtetimi se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale.

UDHËZIM PËR APLIKIM:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga data e publikimit dhe mbyllet më datë 31.1.2018. Për datën dhe orën intervistimit ju njoftojmë menjëherë pas mbylljes së konkursit, në webfaqen e komunes dhe tabelen e shpalljeve. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me dokumentet e cekura më lart.

Vërejtje : Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen si dhe nuk kthehen pas konkurimit.

